

VENDIM
Nr. 507, datë 13.9.2017

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË
SË KULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

II. Ministria e Kulturës, në përputhje me Kushtetutën, kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Hartimin, programimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare të kulturës, trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore, të rritjes së tolerancës fetare e të dialogut kulturor dhe integritetit kulturor në familjen evropiane e botërore, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

2. Hartimin dhe bashkërendimin e punës për politikën në fushën e artit e të kulturës, nëpërmjet edukimit të popullsisë, rritjes së vlerave e të trashëgimisë kulturore, nxitjes së investimeve, publike dhe private, në këta sektorë, monitorimit të mënyrës së përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, edukimit në kulturë, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, ruajtjes dhe vijimit të traditës së harmonisë fetare në kulturën shqiptare, si dhe të bashkëpunimit rajonal.

3. Hartimin e politikave mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale ose shpirtërore, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme ligjore e mbështetëse për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi, si dhe për të promovuar arritjet e kulturës shqiptare e për të rritur konkurrencën e produktit shqiptar kulturor përtej kufijve.

4. Hartimin e politikave për ekzistencën e Shqipërisë si një partner aktiv në organizatat ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale, në fushën e artit e të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore, nëpërmjet aderimit në institucionet përkatëse.

5. Udhëheqjen, programimin dhe mbështetjen e veprimtarive kombëtare e ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike e letrare brenda vendit, si dhe përfshirjes e ballafaqimit të vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara edhe ato bashkëkohore, dhe krijimin e një hapësire dialogu mbarëshqiptar e të diversitetit kulturor.

6. Realizimin e regjistrimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të respektimit të të drejtave të autorëve dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, nga subjektet, personat fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike e shkencore.

III. Vendimi nr. 844, datë 27.9.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Kulturës”, shfuqizohet.

IV. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama